



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.6, datë 5.2.2007

**PËR
MIRATIMIN E BONUSIT TË STREHIMIT PËR FAMILJET NË NEVOJË**

Në mbështetje të ligjit Nr.8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, ligjit Nr.9232, datë 13.5.2004 “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”, neni 13, neni 14, neni 15 dhe neni 16, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I:

1. Të miratojë vlerën minimale të qirasë për bonus strehimi sipas zonave:

Për zonën A	20000 lekë
Për zonën B	15000 lekë
Për zonën C	10000 lekë

2. Trajtimi me bonus të familjeve në nevojë, të bëhet vetëm pas dorëzimit dhe verifikimit të dokumentacionit, sipas legjislacionit në fuqi.
3. Ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Njerëzore për zbatimin e këtij Vendimi.
4. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes

K R Y E T A R I

LUAN SHAHOLLARI